

01. 04. 1996

Fier me 19.3.1996

A K T - T H E M E L I M I

PER SHDQERINE PRIVATE AVN - SHPK CABLE-TELEVISION

PER SHPERNDARJEN E SINJALIT TE SATELITIT ME KABELL

FIER - ALBANIA

Ne Fier sot me date 19.3.1996 ne te nenshkruarit :

1. Fatos Mihali i biri i Rakos dhe i Uranise, lindur me 1955 ne Tirane ; banues ne lagjen "29 Nendori" Fier rr.Dervish Hekali, pallati Nr. 19, i martuar, me femije, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me profesion inxhiner.

2. Assen Tochev i biri i Gueorguievit dhe i Violetes, lindur me 1971 ne Sofie Bullgari, banues ne Sofie - Strellbishte, rruga Hajdushke Gora, pallati Nr;18, beqar, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Bullgare, me profesion ekonomist - Finance.

Te dy palet duke patur parasysh kerkesat e Ligjeve Nr.7512 date 19.8.1991 qe bene fjale "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit", te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 qe bene fjale "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjen Nr.7764 date 2.11.1993 "Per investime e huaja", me te cilat jemi njohur rregullisht, me deshiren dhe vullnetin tone te lire vendosem ne mbledhjen e pare te ortakëve te krijojme shoqerine private per shperndarjen e sinjalit te satelitit me kabell , me emrin AVN CABLE TELEVISION SHPK.FIER.

Per krijimin e kesaj shoqerie kemi patur parasysh dhe kemi percaktuar sa me poshte :

- Objekti i shoqerise private ne veprimtarine e vet do te kete shperndarjen e sinjalit te satelitit me kabell.

- Emri i shoqerise private eshte vendosur te jete : AVN CABLE TELEVISION SHPK FIER-ALBANIA.

- Qendra e veprimtarise se shoqerise AVN CABLE TELEVISION eshte ne adresen : Lagja "29 Nendori" Rr.Dervish Hekali , pallati Nr.19 Fier.

- Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK Fier do kete zotesi te plate juridike per te vepruar , per te fituar te drejt dhe per te marre persiper detyrime civile ne momentin e krijimit dhe qasti i rregjistrimit prane gjykates rrethit Fier.

- Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION shpk do te kryeje me veprimtarine e vete qdo veprim qe i lejon ligji, akti i themelimit dhe statuti.

- Per pergjegjesine e shoqerise private AVN CABLE TELEVISION , si person juridik do te zbatchen kerkesat e neneve 32 e 33 te Kodit Civil.

- Per veprimtarine private te shoqerise AVN CABLE - TELEVISION SHPK ; pergjigjen ne menyre te barabarte te dy ortakët duke qene se kapitali i vene ne temel te krijimit te shoqerise eshte i barabarte nga 1/2 secili.

- Si kapital themelor per krijimin e shoqerise te dy ortakët kemi vendosur shumen 100.000 leke nga 1/2 secili.

- Fitimi neto e shoqerise qe do te rrjedhe nga veprimtaria e saj e sherbimit ndaj klienteve do te ndahet ne menyre te barabarte midis ortakëve nga 1/2 secili , ne te njejten kohe edhe humbja ngelet ne llogari te ortakëve ne te njejten mase.

- Administratori i shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK eshte ortaku shqiptar Fatos Mihali , veprimtaria e te cilit si dhe pergjegjesia e tij eshte parashikuar ne nenin 31 te Kodit Civil dhe nenin 50 te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare

- Aktiviteti privat i shoqerise do te vazhdoje per nje periudhe mbi 10 vjet.

- Organi vendimor i shoqerise AVN CABLE TELEVISION shpk do te jete mbledhja e ortakëve.

- Ortaku me kombesi dhe shtetesi bullgare Assen Tochev mbi bazen e Ligjes Nr.7764 date 2.11.1993 "Per investimet e huaja", ka te drejten e transferimit te pjeses se vet te fitimit dhe pjeses se kapitalit te vlefte apo ne natyre.

- Pjesen e vet te kapitalit qdo ortak mund ta transfer

lirisht ortakut tjetër, ose tek te tretet sipas ligjes, dhe te vertetuar me akt noterial, pa demtuar aktivitetin dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe pjeset e kapitalit secili ortak ka te drejte ti transferoje edhe ne rruge trashegimie.

- Secili ortak , apo administratori ndalohet te lidhe marrveshje qe vijne ne kundërshtim me interesat e shoqerise.

- Administratori, qofte edhe njeri prej ortakeve ne kete cilesi, ka pergjegjesi ligjore para asamblese se ortakeve per shkelje te statutit apo ligjes gjate administrimit te shoqerise.

- Administratori mund te shkarkohet me vendim te mbledhjes se ortakeve.

- Shtimi i kapitalit nepermjet pranimit te ortakeve te rinj behet me vendim te mbledhjes se ortakeve.

- Wardheniet ekonomiko- financiare ndiqen prej administratorit dhe ne zbatim te vendimeve te asamblese se ortakeve.

- Zmadhimi i kapitalit ne vlere apo ne natyre nepermjet kontributeve behet ne marrveshje te ortakeve me raport te miratuar nga ortakët dhe qe i bashkelidhet statutit te shoqerise. Ne te njejten menyre veprshet edhe per zvogelimin e kapitalit ne natyre apo ne vlere.

- Shoqeria AVN CABLE TELEVISION SHPK nuk prishet kur falimenton apo shfaq paaftesi njeri prej ortakeve. Kjo shoqeri nuk prishet as kur vdes apo largohet me deshiren e vet njeri prej ortakëve pervec kur do te parashikohet ndryshe ne ndryshimet qe mund ti behen statutit.

- Menyra e mbarimit dhe e likuidimit te shoqerise do te parashikohet ne menyre te shprehur ne **statutin** e saj.

- Mosmarrveshjet midis ortakeve, apo midis njerit prej ortakeve dhe shoqerise , po qe s'ë nuk do te jete e mundur te zgjidhet me pajtim , do te zgjidhen nga gjykata e vendit ku ka seline shoqerise.

- Per detyrimet e ortakut me kombesi dhe shtetesi Bullgare sanksionet gjyqesore qe rrjedhin nga vendimet e gjykates se vendit ku ka seline shoqeria AVN CABLE TELEVISION SHPK, mund te zbatohen edhe nga organet e permbarimit gjyqesor te vendbanimit te shtetasit me kombesi dhe shtetesi bullgare.

01. 04. 1996

-4-

- Te dy ortakët marrim persiper detyrimin për zbatimin me korektësi të kërkesave të ligjeve të shtetit shqiptar që bëjnë fjalë për veprimtarinë private, si dhe shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj shtetit, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë private të shërbimit të kabllit televiziv.

- Shoqëria private AVN CABLE TELEVISION SHPK ka të drejtën për të patur pranë bankës (Dega Fier) të një numuri të llogarive se saç rrjedhese.

- Shoqëria private AVN CABLE TELEVISION SHPK FIER ka edhe të drejtën e përdarimit të valesë së vet kryesore me këtë përmbajtje :  
AVN CABLE - TELEVISION SHPK FIER-ALBANIA.

Ky akt themelimi (kontratë), pasi lexohet gjendet i shkruar dhe shprehur drejt vullnetit të ortakëve, dhe pas kësaj akti nënshkruhet rregullisht pa vërejtje. - - - - -

O R T A K E T

/ FATOS MIHALI /

/ ASSEN TOCHEV

*Fatos Mihali*  
*[Signature]*

*[Signature]*  
*Asen Tochev*

REPUBLICA E SHQIPËRISE

ZYRA E NOTERISE FIER

Fier më 19.3.1996

Nr. 2798 Regj.

V E R T E T I M - N O T E R I A L

Në Fier sot më datë 19.3.1996 para meje noterit Minella Milo u paraqitën personalisht dhe pasi u verifikuan dokumentat identifikuese rezultoi se : 1.Fatos Mihali i biri i Rakos dhe i Uranisë, lindur më 19... në Tiranë, banues në Fier, lagja "29 Nëntori" , me zotësi të plote juridike për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i njohur me pasaportë Nr.673650 leshuar nga D.P.B.Fier, dhe 2.Assen Tochev i biri i Gueorgjës dhe i Violetës, lindur më 1971 në Sofje-Bullgari, banues në Sofje, me zotësi të plote juridike për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi bullgar i njohur prej meje me pasaportën Nr.4286851 leshuar nga Rajoni i policisë Sofje, të cilët janë me cilësinë e ortakut të dy në shoqërinë AVN CABLE TELEVISION SHPK dhe që në praninë time nënshkruan me feshirë dhe vullnetin e tyre të lirë këtë akt themelimi. Une noteris vertetoj

N O T E R I

/ MINELLA MILD



I SHOQERISE PRIVATE AVN CABLE-TELEVISION SHPK  
PER SHPERNDARJEN E SINJALIT TE SATELITIT ME KABELL

FIER - ALBANIA

Mbeshtetur ne kerkesat e Ligjeve Nr.7512 date 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit, ne dispozitat e Ligj Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e Ligj Nr.7764 date 2.11.1993 "Per investimet e huaja" si dhe mbi bazen e akt te themelimit date 19.3.1996 te bere midis ortakeve Fatos Mihali dhe Assen Tochev perpilohet ky statut per te rregulluar veprimtarine private shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK me qender ne qytetin e Fierit.

Ne perpilimin e ketij statuti per rregullimin e veprimtarise se shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK , i cili eshte i detyruesh per t'u zbatuar nga ortaket e kesaj shoqerise, jane mbajtur parasysh sipas ligjes sa me poshte :

1. Objekti i veprimtarise private i shoqerise AVN CABLE - TELEVISION SHPK.
2. Kapitali themelor i shoqerise.
3. Si do te behet drejtimi administrativ.
4. Si do te zbatohen rregullat ekonomiko-financiare.
5. Si do te zbatohen mardheniet kontraktore dhe ato te punesimit.
6. Jane mbajtur parasysh qendra e veprimtarise, emri i saj, dhe te drejtat e detyrat e ortakeve dhe i shoqerise ndaj shtetit.

I. OBJEKTI I VEPRIMTARISE PRIVATE I SHOQERISE AVN.

N e n i 1

Duke patur parasysh aktin e themelimit te shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK i perpiluar ne daten 19.3.1996 qe eshte dita e pare e mbledhjes se ortakeve, objekti i veprimtarise i shoqerise eshte Shperndarja e sinjalit te satelitit me kabell.

N e n i 2

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK eshte person

01. 04. 1996

juridik privat dhe ka pavaresine e vet pasurore, pergjegjesi te pavarur pasurore, si dhe merr pjese vete ne qrkullimin civil ne emer te saj.

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK do te mbaje vete pergjegjesi per detyrimet e saj.

N e n i 3

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK e ka fituar zotesine per te vepruar qe nga momenti i rregjistrimit te saj ne gjykaten e rrethit Tirane.

Rregjistrimi i shoqerise si person juridik privat eshte bere me :

Vendimin Nr. \_\_\_\_\_.

Date \_\_\_\_\_.

Data e fillimit te veprimtarise eshte: \_\_\_\_\_.

N e n i 4

Qendra e veprimtarise e shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK eshte ne adresen : Lagja "29 Nendori" Rr.Dervish Hekali" Pll. Nr.19. Fier.

N e n i 5

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar nga ortaket Fatos Mihali me kombesi dhe shtetesi shqiptare dhe Assen Tochev me kombesi dhe shtetesi bullgare, te cilet do te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themelor te shoqerise.

Emri i administratorit te shoqerise Fatos Mihali do te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat qe nxjerr shoqeria duke ju drejtuar te treteve.

N e n i 6

Shoqeria AVN CABLE TELEVISION SHPK ka te drejte te kryej investime te vazhdushme per permiresimin e kushteve te sherbimit ndaj klienteve te vet.

Veprimtarine e vet shoqeria AVN shpk do ta ushtroje ne menyra te pavarur dhe kushtet e bashkeveprimit, te kooperimit si dhe te konkurences se lire me subjektet e tjera private apo shteterore; qe mund te krijohen ne kete fushe te veprimtarise se sherbimit.

N e n i 7

Akti i themelimit i shoqerise qe mban daten 19.3.1996 u be

01. 04. 1996

me pjesmarrjen direkte te dy ortakëve duke u paraqitur personalisht gjate perpilimit te tij dhe ne momentin e nenshkrimtit para noterit.

## II. KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE.

### N e n i 8

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke te derdhura ne banken e shtetit.

Kapitali themelor i shoqerise ne te holla eshte vendosur me kontributin e perbashket te ortakëve me kombesi dhe shtetes shqiptare Fatos Mihali dhe atij me kombesi dhe shtetesi bullgare Assen Tochev , duke patur secili ne keto kontribut nga 1/2 pjese.

Pas fillimit te veprimtarise se shoqerise kontributi ne te holla apo ne natyre mund te shtohen duke importuar apo blere ne vend mjete e paisje per te cilat te dy ortakët kane per detyre ti rregjistrujne ato ne inventarin e shoqerise dhe t'u bejne vleresimin me raport te veçante qe do ti bashkelidhet aktit te themelimit dhe statutit. Vleresimi i kontributit ne natyre do te hartohet me pergjegjesi nga nje ekspert i miratuar me pelqimin e te dy ortakëve , dhe ky dokument do te siglohet ne noterit.

### N e n i 9

Pjeset e kapitalit qe mund te vendosen me vone nuk mund te perfaqesohen me letra me vlere.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themelor per nevojat e shoqerise gjithashtu duhet te vertetohen me akt noterial.

Ortaku me kombesi dhe shtetesi bullgare Assen Tochev ka te drejten e transferimit te pjeseve te fitimit dhe te kapitalit themelor pa cenuar veprimtarine e shoqerise , dhe kjo pas vertetimit me akt noterial te pjeseve se tij nga pjestimi vullnetar apo ai gjyqesor me vendim te gjykates se vendit ku ka seline shoqeria.

### N e n i 10

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferushme me rruge trashegimie, ndermjet bashkeshortëve si dhe ndermjet pasardhësve dhe paraardhësve.

01. 04. 1996

Me vendim te mbledhjes se ortakëve, bashkeshorti apo pasardhesi e paraardhesi i ortakut mund te jete ortak ne shoqeri.

N e n i 11

Pjeset e kapitalit themelor mund ti transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me vendimin e perbashket te ortakëve te kesaj shoqerie, ose te ortakëve qe do te perfaqesojne 3/4 e ortakëve ne kapitalin themelor pas shtimit te numurit te tyre.

Pjeset e kapitalit mund te transferohen lirisht edhe midis ortakëve te shoqerise, perveç kur per kete kane kundershtim ortakët e tjere kur te jene me shume se dy, dhe kjo po qe se ata e motivojne se nga ky veprim vihen ne pozita te disfavorshme ndaj ortakut qe perfiton nga ky transferim.

III. DREJTIMI ADMINISTRATIV.

N e n i 12

Organi vendimor i shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK eshte mbledhja e ortakëve. Vendimet e mbledhjes se ortakëve kane fuqi per tu zbatuar po qe se jane miratuar me vullnet te lire nga ortakët ose po qe se per kete vendim do te votojne 3/4 e ortakëve, ose te ortakut qe do te perfaqesojne 3/4 e kapitalit themelor te shoqerise, dhe kjo pas shtimit te ortakëve te shoqerise.

Lidhur me kete çeshtje jane te detyrueshme te zbatohen urdherimet e neneve 57, 58 dhe 59 te Ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare".

N e n i 13

Me vendim te mbledhjes se ortakëve mund te vendoset zmadhimi kapitalit ne natyre apo ne te holla ne monedhe vendi apo te huaj, dhe kjo çeshtje duhet te behet me akt noterial, te cilit i bashkelidhet vendimi i mbledhjes se ortakëve.

N e n i 14

ADMINISTRATORI

Administratori i shoqerise ne mbledhjen e pare te ortakëve eshte caktuar ortakut me kombesi dhe shtetesi shqiptare Fatos Mihali.



Administratori i shoqerise Fatos Mihali <sup>01.04.1996</sup> nuk do te jete i emeruar ne kete vend per gjithë kohën, sepse ne kete detyre me vendim te mbledhjes se ortakëve mund te vendoset nje ortak tjetër si dhe mund te vendoset <sup>edhe</sup> nje specialist që do te kete njohuri dhe aftësi per kete fushe ne drejtimin e shoqerise.

Administratori do te marr te gjitha kopetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise AVN CABLE - TELEVISION SHPK , ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kopetencave qe me ligje u njihen vetem ortakëve.

Shoqeria AVN CABLE TELEVISION SHPK me vendim merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet qe ka perpiluar administratori, kur veprimet e tij perfshihen ne objektin e veprimtarise se shoqerise, dhe nuk merr persiper pranimin e akteve te nenshkruara nga administratori si dhe detyrimet ndaj te treteve qe rrjedhin nga keto akte, kur te tretet e dine si dhe kur shoqeria e provon se veprimet e administratorit i kane kaluar kopetencat e tij.

N e n i 15

Per veprimet e administratorit dhe mardheniet e tij, si dhe veprimtaria qe do te ushtroje do te rregullohen sipas urdherimeve te neneve 50,51,52,53 dhe 55 te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare.

IV. MARDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

N e n i 16

Mardheniet ekonomiko-financiare te shoqerise AVN SHPK do te ndiqen nga ortakun administrator Fatos Mihali si dhe specialisti perkates qe do te puneschet prane shoqerise qe ne mungese te administratorit apo ortakëve do te veproje me autorizim, ose me prokure.

Mjetet monetare te shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK do te ruhen ne Banke ne llogarine Nr. \_\_\_\_\_.

Mjetet monetare ne kete llogari jane te prone e shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK. Keto mjete mund te perdoren vetem me urdher te ortakut administrativ ose te personit te ngarkuar prej tij me autorizim apo prokure sipas vendimit te mbledhjes se ortakëve.

01. 04. 1996

si per blerjen e mallrave dhe per pagimin e puntoreve edhe per likuidimin e shpenzimeve te shoqerise.

N e n i 17

Mjetet monetare te shoqerise AVN CABLE TELEVISION SHPK mund te levizen (ne pakesim) edhe nga vete banka kur jane rastet e parashikuara ne ligje si :

- Kur vihet ne ekzekutim nje vendim gjyqesor.
- Kur vihet ne ekzekutim nje vendim i organit te kontrollit financiar apo organeve te tjera te kontrollit per shkelje te bera nga ortakët apo punonjesit gjate ushtrimit te veprimtarise private. Vendimi i organit te kontrollit duhet te jete i konfirmuar prej njerit nga ortakët , dhe ne mungese te tyre nga ndonjери prej punonjesve te shoqerise.

N e n i 18

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK per te saktësuar ne veprimtarine e saj private gjithe aktivitetin e vet, merr persiper te pasqyroje me saktësi sipas kerkesave te ligjes mbi kontabilitetin sa me poshte :

- inventarin e kapitalit te saj te palujtshem.
- inventarin ~~dh~~ e materjaleve dhe lendeve te para.
- veprimet e saj ekonomike- financiare.
- pagen e punonjesve.
- levizjen e mjeteve.
- gjendjen ne banke.

N e n i 19

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK e themeluar nga ortakët Fatos Mihali e Assen Tochev, ka per detyre te derdhe rregullisht ne interes te shtetit apo ne organizma te tjera :

- detyrimet per tatimet dhe taksat.
- detyrimin per kontributin shoqeror.
- detyrimin per sigurimin e pasurise.

N e n i 20

Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te vitit nga aktiviteti e veprimtaria private e shoqerise eshre prone e ortakeve dhe ndahet ne perputhje me raportin e vendosur ne aktin e themelimit

01. 04. 1996

te shoqerise nga 1/2 secili , ne te njejten kohe edhe humbja ngelet ne llogari te ortakeve ne pjese te barabarta.

V. MARDHENIET KONTRAKTORE TE SHOQERISE AVN shpk.

N e n i 21

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION SHPK duke qene person juridik privat per shperndarjen e sinjalit te satelitit me labell , me veprimet e veta do te fitoje te drejta dhe do te marre persiper detyrime per te cilat do te pergjigjet me mjetet e veta financiare, brenda kufijve te parashikuar ne ligje apo ne kontrata.

Per te disiplinuar veprimtarine dhe aktivitetin e saj privat shoqeria AVN CABLE TELEVISION shpk ne mardhenie me klientet e vet apo te tretet do te lidhe kontrata ku do te specifikohen te drejtat dhe detyrimet reciproke.

N e n i 22

Ne kontratat qe do te lidhe shoqeria private AVN shpk do te do te parashikohen me saktesi llojet e sherbimit qe do te kryhen , çmimi i sherbimit, detyrimet e paleve per mosrespektimin e kushteve te kontrates etj.

N e n i 23

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION shpk nuk ka kufizime per te lidhur kontrata me persona fizik apo juridik , shqiptar apo te huaj , qe ushtrojne veprimtarine e tyre private brenda kufirit te lejuar teknikisht per shperndajren e sinjalit te satelitit me kabell. Keto kontrata duhet te lidhen ne perputhje me interesat e saj dhe qe do te jene brenda kushteve qe cakton ligja.

N e n i 24

Mardheniet juridike te punes ne veprimtarine private te shoqerise AVN CABLE TELEVISION shpk me te punesuarit do te rregullohen gjithashtu me kontrate individuale apo kolektive, te cilat do te lidhen lirisht midis shoqerise te perfaqesuar nga administratori nga njera ane , dhe te punesuarit nga ana tjeter.

VI. MARDHENIET E PUNESIMIT .

N e n i 25

Marrjax ne pune e punesive prane shoqerise AVN CABLE -

01.04.1996

TELEVISION shpk do te behet nga vete kjo shoqeri duke patur parasysht aftesite fizike,arsimore dhe profesionale te te punesuarit si dhe ne perpathje me nevojat qe ka shoqeria.

Marrja ne pune dhe fillimi i punes nga i punesuari prane kesaj shoqerie do te behet me rregjistrimin e tij ne rregjistrin e shoqerise si dhe pas nenshkrimit te kontrates se punes.

N e n i 26

Shoqeria AVN CABLE TELEVISION shpk pas marrjes ne pune te te punesuarit dhe me nenshkrimin e kontrates se punes(individueale dhe kolektive),mbeshtetur ne kerkesat e ligjes Nr.7512 date 10.8.1991, merr persiper detyrimin te njoftoje me shkrim organet e punesimit te juridiksionit ku ushtrone veprimtarine apo ku ka seline kjo shoqeri.

N e n i 27

Me marrjen ne pune te te punesuarit shoqeria AVN CABLE TELEVISION njeh detyrimin te zbatoje kriteret e percaktuara ne Kodin e punes.

Kontrata qe do te lidhe kjo shoqeri me punonjesit( me te punesuarit) detyrimisht duhet te permbaje :

- Daten e lidhjes se mardhenies juridike te punes.
- Kushtet e domosdoshme si profesioni,vendin e punes,afati probes.
- Shperblimi i punes (paga) si dhe shperblimet e tjera qe lidhen me te.
- Detyrimet e shoqerise per zbatimin e kerkesave te ligjes per mbrojtjen ne pune.
- menyren e percaktimit te pergjegjesise materjale.
- menyren e zgjidhjes se mosmarrveshjeve, si dhe rastet kur zgjidhet marrveshja e punes.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT.

N e n i 28

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION shpk mund te pushoje veprimtarine e saj private dhe te vihet ne likuidim, por gjithmone kjo shoqeri do te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit se secilit ortak ne kapitalin themelor te shoqerise.

Shoqeria AVN CABLE TELEVISION shpk ne momentin e mbarimit me vendim te mbledhjes se ortakëve cakton ekspert kontabel dhe mbarimi vendoset pas miratimit te bilancit perfundimtar.

## N e n i 29

Veprimtaria e eksperteve kontabel do te rregullohet sipas dispozitave te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare".

## N e n i 30

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION shpk mund ti jape fund veprimtarise se saj edhe ne formen e likujdimit. Likujdimi i shoqerise do te behet me realizimin e te drejtave dhe pagimin e detyrimeve nga likujdator qe do te caktoje mbledhja e ortakëve.

Kur veprimtaria e shoqerise do te nderpritet per shkak te veprimtarise se kunderligjeshme pasuria shkon ne favor te shtetit.

Po qe se veprimtaria e shoqerise do te pushoje per shkak falimentimi , kjo do te rregullohet sipas kerkesave te dispozitave te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare".

VIII. TE TJERA .

## N e n i 31

Shoqeria private AVN CABLE TELEVISION shpk nuk mund te falimentoje apo te likujdohet dhe te priset kur shfaq paaftesi njeri prej ortakëve , apo kur njeri prej ortakëve kerkon te largohet nga shoqeria.

Shoqeria nuk mund te priset apo te likujdohet po qe se njeri prej ortakëve vdes,perveç se do te zbatchen ne kete rast transferimi i pjeses se kapitalit ne rruge trashëgimie , apo blerja e pjeses se kapitalit nga trashëgimtarët nga njeri prej ortakëve.

## N e n i 32

Çeshtja e pushimit te parakohshem te veprimtarise se shoqerise AVN CABLE TELEVISION shpk per efekte te humbjes se gjysmes se kapitalit themelor do te rregullohet sipas kerkesave te nenit 72 te Ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare "

01. 04. 1996

-10-

N e n i 33

Ndryshimet e statutit te kesaj shoqerie mund te behen me vendim te mbledhjes se ortakëve ose te ortakëve qe perfaqesojne 3/4 e pjeseve te kapitalit themelor.

N e n i 34

Shoqeria AVN CABLE TELEVISION shpk ka te drejten e perdorimit te vales se vet me kete permbajtje :AVN CABLE-TELEVISION SHPK FIER-ALBANIA.

Ky statut u miratua rregullisht nga mbledhja e ortakëve dhe eshte i detyrueshem per t'u zbatuar.Pasi u lexua u gjend i shkruar drejt dhe nenshkruhet rregullisht nga ortakët.

O R T A K E T

/ FATOS MIHALI / / ASSEN TOCHEV

*Fatos Mihali*

*Assen Tochev*

REPUBLICA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE FIER

Fier me 19.3.1996

Nr. 2798 Regj;

V E R T E T I M - N O T E R I A L

Ne Fier sot me daten 19.3.1996 para meje noterit Minalla Milo u paraqiten personalisht dhe pasi u verifikuan dokumentat identifikuese rezultoi se : 1.Fatos Mihali i biri i Rakos dhe i Uranise,lindur me 1955 ne Tirane,banues ne lagjen "29 Nendori " Fier,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me kombesi dhe shtetesi shqiptare,i njohur me pasaporten Nr.673650 leshuar nga D.P.B.Fier dhe 2. Assen Tochev i biri i Gueorgievit dhe i Violetes,lindur me 1971 ne Sofje Bullgari,banues ne Sofje,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me kombesi dhe shtetesi bullgare,i njohur prej meje me pasaporten Nr.4286851 leshuar nga rajoni i policise Sofje Bullgari, te cilet jane me cilesine e ortakut ne shoqerine AVN CABLE TELEVISION shpk dhe qe ne pranine time nenshkruan me deshiren dhe vullnetin e tyre te lire kete akt themelimi Une noterit e vertetoje. - - -

N O T E R I

/ MINELLA MIHALI



*Minella Mihali*

